



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal of Kaçanik

01Nr. 60/01-32297/23  
Kaçanik, 20.12.2023

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **XI (njëmbëdhjetë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatora e VII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 20 dhjetor 2023. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës në mbledhje nga Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF ishin 6 anëtarë: Kemal Murseli, Kadri Krivenjeva, Fitore Vishi, Agim Mani, Ardita Rrahmani, Rabije Sallahi. Në mbledhje mungoj me arsye, Kadrije Lika-Troni.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë: Nënkryetari i Komunës: Sabedin Vishi, Qamil Stagova-DUKMM, Pranvera Loku-Zharku- DZHET.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Procesmbajtës: Makfire Malsiu- Zyrtare për punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, pjesëmarrës në këtë mbledhje janë 6 anëtarë, me arsye mungon Kadrije Lika-Troni. Kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e XI (njëmbëdhjetë) të rregullt të KPF-a për vitin 2023, data 24 dhjetor, me këtë:

### REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Rekomandimi i komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në parcelën kadastrale Nr.70917093-00156-7, me sipërfaqe 00.55.00 ha në ZK Koxhaj, ERA PLAST – SH.P.K ;
3. Propozim Vendim për aprovimin e Listës së veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2024;
4. Propozim Vendim për aprovimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024 ;
5. Propozim Vendim për ndërrimin e destinimit të tokës pyjore në ndërtimore, në parcelën kadastrale Nr.P-70917083-00112-3, ZK Kaçanik i Vjetër.

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtoj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF,

### Aprovoj

**Rendin e punës në përbërje prej 5 pikave.**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF

## Aprovoj

**Procesverbalin e mbledhjes së X (dhjetë) të rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) për vitin 2023 të datës 24.11.2023 / Lënda: 01Nr. 060/01-30020/23.**

2. Rekomandimi i komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në parcelën kadastrale Nr.70917093-00156-7, me sipërfaqe 00.55.00 ha në ZK Koxhaj, ERA PLAST – SH.P.K ;

**Kryesuesi i Kuvendit:** E hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Nëse ka mundësi me na sqaruar drejtori me në detaje se nuk po e kuptoj sa duhet. Këtu është vetëm një ofertues që e merr pronën, ndërkaq kanë ofertuar dy, në disa raste kemi nga një ofertues.

**z. Qamil Stagova:** Komisioni vlerësues e ka vlerësuar si ofertues serioz, këtë që e ka rekomanduar.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Me këtë shpallje publike kanë qenë 3 parcela, ndërkaq këtë herë nuk ka pasur as ofertues për krejt parcelat.

**znj. Pranvera Loku-Zharku:** Ka pasur edhe parcela tjera të cilat kanë dalë në ankand publik, por nuk ka pasur ofertues, ndërsa për parcelën që është rekomanduar me ia dhënë “Era Plast” si kompani me e përshtatshme, ka pasur dy ofertues.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, e shtoj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF

## Aprovoj

**Rekomandimi i komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në parcelën kadastrale Nr.70917093-00156-7, me sipërfaqe 00.55.00 ha në ZK Koxhaj, ERA PLAST – SH.P.K. Ky Propozim Vendim i Rekomandohet**

**Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.**

3. Propozim Vendim për aprovimin e Listës së veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2024;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Sipas ligjit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, në fund të çdo viti duhet të miratohet lista për pronat që planifikohen të epën në shfrytëzim në vitin vijues. Nëse një pronë nuk është në listën e aprovuar, nuk mund të epët në shfrytëzim në vitin vijues. Komuna duhet ta ketë listën dhe të bëjë publike, ndërkaq nuk do me thënë që të gjitha këto prona kanë me u dhënë në shfrytëzim, sepse ka mundësi me pasur ndonjë investitor apo ofertues serioz në vitin vijues. E hapi diskutimin:

**z. Ardita Rrahmani:** Ne po i shohim zonat kadastrale, p.sh. në Gllloboçicë, por nuk e njohim atë terren. Gjithashtu me ditur se cilat prona janë të reja, kjo me u dhënë si informatë në KK, që me i pasur ne të qarta për vete dhe për qytetarë.

**z. Qamil Stagova:** Në listë janë disa prona që janë përsëritur nga vitet e kaluara, ka edhe prona që janë shtuar të reja.

**Kryesuesi i Kuvendit:** E vetmja mundësi është me i gjetur parcelat përmes gjeoportalit, tani i kemi marrë 2 TV dhe 1 Video projektor statik, dhe ka me qenë sqarimi me i lehtë. Në listë mundet me u shënuar, pronat e përsëritura dhe pronat e reja.

**znj. Fitore Vishi:** Kohëzgjatje e dhënies në shfrytëzim të pronave komunale, a vendoset pasi të hapet ankandi publik?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Fillimisht miratohet lista e pronave, pastaj për secilin rast formohet komisioni vlerësues. Nëse ka shprehje të interesit për një pronë, atëherë propozimi vjen nga DUKMM për me formuar komisionin, i cili i udhëheqë procedurat e ankandit dhe zgjedhjen e ofertuesve. Rekomandimi vjen në KPF dhe në KK miratimi. Pas miratimit nga KK nënshkruhet kontrata në mes kryetarit dhe ofertuesit. Mbikëqyrjen e kontratave është në kompetencë të ekzekutivit dhe në obligim ligjor me raportuar në KK se ku kanë mbërri zhvillimet në ato prona. Raportimi i fundit në KK ka ndikuar shumë, janë vetëdijesuar personat që mos me aplikuar lidhje e pa lidhje, se i patëm 8 prona, ndërkaq vetëm 1 ofertues serioz që i ka plotësuar kushtet. Kjo duhet të përcillet në vazhdimësi, sepse e lehtëson punën edhe të ekzekutivi dhe i zgjedhë njerëzit që kanë plane me punuar. Ne jemi me iu ndihmuar bizneseve, jemi me zhvilluar vendin, por jo me bërë pazare me tokat e komunës.

**z. Ardita Rrahmani:** Të parcelat e reja drejtor, a kanë ardhur si rezultat i kërkesës së ofertuesit-investitorit, apo si rezultat i propozimeve të juaja?

**z. Qamil Stagova:** Ne kemi pasur kërkesa për me marrë në shfrytëzim një pronë të komunës. Investitorët nuk e dinë se në çfarë kohe komuna jep toka në shfrytëzim. Për ato prona që kemi pasur interes, në bazë të kërkesave e kemi plotësuar listën.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Komuna nuk ka shumë prona komunale, se janë më tepër pronat private. Mbi 2 ha janë në ZK Koxhaj, por aty nuk ka rrugë. E para pikë, aty komuna duhet me ndërtuar infrastrukturën rrugore Më herët aty janë dhënë 2 prona në shfrytëzim, tani është e 3-ta, janë edhe 2 tjera të cilat në të ardhmen kanë me u dhënë, dhe aty krijohet një zonë e vogël industriale apo park i vogël biznesi. Me vjen mirë që në planifikimin e biznesi është paraparë me u punësuar numër i konsiderueshëm i femrave, se janë do punë të lehta, si ambalazh etj. të cilat punë munden me i kryer edhe femrat.

**z. Ardita Rrahmani:** Këtu po krijohet një standard i dyfishtë, sepse gjatë këtij viti ka qenë një parcelë që është kërkuar nga Xhevdet Dërvishi. Ne si LDK kemi insistuar dhe nuk ka të bëjë këtu me individin, këtu ka të bëjë me neglizhencën ose krijimin e standardit të dyfishtë. Qëllimi ka qenë me gjeneruar vende pune, kështu që dikujt i epët prona, dikujt jo. Ai ka kërkuar pak pronë, ndërkaq ju ka ofruar shumë dhe ka kërkuar me ndarë. Afati prej 6 muajve ka kaluar dhe është dashur me u proceduar lënda në KK.

**z. Qamil Stagova:** Me ndarë nuk ka qenë problem propozimi, por ka qenë problem veprimtaria tregtare.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Të ky ofertues nuk ka qenë problem ndarja e parcelës, por veprimtaria tregtare. Është mirë me udhëhequr procedurën e dhënies me qira, sikurse e kemi pasur një pronë të Nikaj, se veprimtaria duhet me qenë prodhuese, se nuk është në rregull as për ne me dhënë pronë me qira për market.

**znj. Pranvera Loku-Zharku:** Nuk është kriter vetëm gjenerim të vendeve të punës, kriteret janë me tepër për veprimtari prodhuese.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kriteret e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale janë: Veprimtaria ekonomike, përfitimi ekonomik i komunës, numri i të punësuarve, vlera investimit. Veprimtaritë hoteliere tregtare unë për veti nuk kisha lejuar me u dhënë prona në shfrytëzim. Për veprimtarit prodhuese, bile në rregullore ceket për ato veprimtari prodhuese që e plasojnë prodhimin jashtë, kështu që atë pronë që e ceku Ardita, duhet zhvillohet procedura e dhënies

me qira, përmes ankandit publik, caktohet një çmim fillestar, pastaj kush jep çmimin me të lartë, e merr pronën me qira.

**znj. Pranvera Loku-Zharku:** Qëllimi është të rritet eksporti dhe zvogëlohet importi.

**z. Ardita Rrahmani:** Ne jemi anëtarë të KK dhe do të ishte me korrekte nëse na kthehet një përgjigje zyrtare.

**z. Qamil Stagova:** Ne në fillim nuk e kemi ditur, kemi dhënë pronë edhe për veprimtari që nuk është dashur me dhënë, si për autoservis apo të ngjashme.

**Nënkryetari i Komunës -Sabedin Vishi:** Zakonisht prodhimi fuqizohet për me rritë ekonominë e vendit. Me ia dhënë dikujt një pronë, po e themi për “një dyqan”, nëse komisioni vlerësues ka bërë ndonjë gabim, ne nuk duhet bërë gabime, ndoshta kemi bërë ndonjëherë, por tani edhe si KK edhe komisioni vlerësues duhet me qenë të vëmendshëm që prona me iu dhënë në shfrytëzim atyre që e zhvillojnë ekonominë lokale, se si komunë ne nuk kemi shumë prona komunale në ato vende që kërkohen me tepër. Mirë është me konkretizuar edhe çështjen e pronës që e ka kërkuar Xhevdeti.

**z. Ardita Rrahmani:** Në atë aspekt e kam unë, që ne si anëtar të KK, mos me lënë pezull çështjen e pronës që ka kërkuar Xhevdeti se pala besoj se është e njoftuar me tepër se ne, por ne si anëtarë të KK duhet me zgjidhur këtë çështje.

**z. Kadri Krivenjeva:** Sa e di unë, ajo zonë është zonë urbane, zonë e banueshme, dhe pjesa lidhet me magjistralen. Është problematike me ndarë, se një pjesë është e pashfrytëzueshme.

**z. Qamil Stagova:** Ne mundemi me ndarë pjesën që e ka kërkuar pala.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Për me ndarë parcelën, duhet me ankand publik, kështu mundet me aplikuar edhe dikush tjetër në ankand.

**z. Agim Mani:** Unë nuk e kam pa atë parcelë që është në listë me u dhënë në shfrytëzim. Në listë shihet se ka parcela të cilat nuk kanë qenë me u dhënë në shfrytëzim në vitin 2023. Nëse ligji e parasheh që duhet me dalë të gjitha parcelat komunale, atëherë cili është ndëshkimi me ligj që në vitin e kaluar nuk janë listuar të gjitha pronat. Nëse nuk ka ndëshkim, mos t'i qesim pronat veç me bërë hajgare, atëherë t'i listojmë vetëm disa me prioritet dhe t'i detajojmë, që mos me pasur mundësi për sipërfaqe të mëdha 2 ha me ofertuar për veprimtari fjala vjen për automekanik. Planin për zhvillimin ekonomik të komunës e bënë ekzekutivi. Komisioni vlerësues e vlerëson në bazë të kriterëve, dhe e procedon për KK. Ekzekutivi i komunës duhet me pasur plan për secilën parcelë, se nëse nuk keni plan, nuk duhet t'i listoni.

**Nënkryetari i Komunës:** Ne mundemi me pasur një investitor të fuqishëm në vitin vijues, por nuk e kemi paraparë në listë atë pronë. Me këtë listë, ne si komunë po ia pamundësojmë me investua një investitor serioz në komunën tonë. Nëse prona është në listë, nuk na kushton asgjë, që t'ua bëjmë të mundur investitorëve serioz me investua. Edhe kryesuesi e përmendi se, raportimet në KK për dhënie në shfrytëzim të pronave komunale kanë ndikuar shumë tek investitorët dhe të ofertuesit tjerë, se nuk kanë me aplikuar me investitori vetëm sa për të marrë atë pronë.

**z. Agim Mani:** Për pronat që listohen, duhet me cekur në prioritet se cili është plani i ekzekutivit për zhvillimin e vendit për 7-8 vite, duke i dhënë detajet dhe përcaktuar kriteret, se e theksoj edhe kryesuesi se nuk mundesh 70-80 ari me dhënë për automekanik.

**Nënkryetari i Komunës:** Kriteret është komisioni që i rekomandon, ndërkaq miratimin e bënë KK.

**z. Agim Mani:** Plani është trajtuar nga komisioni për hartimin e planit të punës së KK. Plani është orientues, ndërkaq propozoj që në muajin e 6 mos të bëhet rishikim buxhetor, se nuk ka të drejtë KK me bërë rishikim të buxhetit. Bëhet planifikimi buxhetor dhe në bazë të planifikimit behet realizimi. Ne mundemi me u mbledhë si KPF dhe mos me rekomanduar asnjë pikë në KK.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Rishikimi i buxhetit nuk varet nga ne. Qeveria e aprovon rishikimin apo nuk e aprovon, ajo varet nga qeveria. Ne nuk e dimë sivjet si ka me vepruar qeveria, sepse nëse mbesin mjete nga projektet, pse mos të rishikojmë buxhetin. Rishikimi e lehtëson barrën buxhetore të komunës. Organizatave buxhetore duhet me iu krijuar mundësi me rishikuar buxhetin, se kjo është shumë me mirë.

**znj. Ardita Rrahmani:** Unë jam mos me u hequr rishikimi buxhetor. Pavarësisht se e kemi miratuar buxhetin në vitin 2024, ne e shohim zbatimin e investimeve kapitale deri në muajin qershor.

**z. Agim Mani:** Me rishikim buxhetor, mundesh me ndryshuar komplet planin buxhetor. Edhe në trajnim kur kam qenë, e kam mësuar se nuk kemi drejtë me bërë rishikim buxhetor.

**znj. Ardita Rrahmani:** Sa e di unë, deri 30% bëhet rishikimi i buxhetit.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Rishikimi i buxhetit bëhet deri 30% të shumës buxhetore, kjo është ligj. Rishikimi buxhetor është përmbledhja e rialokimeve, transfereve. Nëse ka rishikim të buxhetit, nuk ka nevojë për transere dhe rialokime. Në plan të punës është kjo pikë, nuk na kushton, pavarësisht a do të kemi rishikim apo jo. Diskutime të tjera nuk ka. Këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF

#### **Aprovoj**

**Propozim Vendim për aprovimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024. Ky Propozim Vendim i**

#### **Rekomandohet**

**Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.**

**5. Propozim Vendim për ndërrimin e destinimit të tokës pyjore në ndërtimore, në parcelën kadastrale Nr.P-70917083-00112-3, ZK Kaçanik i Vjetër.**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kjo çështje na është adresuar, ndërkaq ministria ka kohë që nuk na i miraton ndërrimin e destinimeve. E hapi diskutimin:

**z. Qamil Stagova:** Sqaroj për lokacionin e parcelës, ZK Kaçanik i Vjetër, me kulturë bujqësore Mal i klasës 1, prona është në afërsi të magjistrales.

**z. Agim Mani:** Nëse duam me ia ndërruar destinimin kësaj prone, ne duhet me ditur se çka ka në plan pronari me ndërtuar në atë pronë, cili është qëllimi, misioni dhe vizioni. Këtu është shënuar, të jetësoj idenë e prodhimit, që të prodhoj produkte të plastikës sipas nevojave të klientëve. Kërkesat ndaj konsumatorëve me ndershmëri dhe përpikëri, të organizoj dhe trajnoj staf aktiv për punë të ndershme dhe përkushtim, furnizimin e tregjeve vendore me një konkurrencë të ndershme për të mbuluar importin aktual, si dhe të avancoj me përkushtim rritje të kapacitetit për pushtuar edhe tregjet e jashtme. Objektivi është, ndërtimi i objektit të fabrikës për prodhim, porosia e makinerive dhe instalimi i tyre në pozicionet e linjës së prodhimit. Komisioni nuk e ka kryer punën si duhet. Komisioni duhet kryer punën e vet në bazë të PZHK, a është ajo pronë e paraparë me PZHK dhe a i plotëson kushtet me iu ndërruar destinimi.

**znj. Fitore Vishi:** Ky është duke hapur mobileri, E ka të detajuar planin e biznesit. Ndoshta është ngatërruar plani i biznesit me ndonjë lëndë tjetër.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Janë ngatërruar faqet me Era Plas të misioni dhe vizioni. Në bazë të PZHK nuk i plotëson kushtet, por pse me tentuar me penguar një person. PZHK e ka bërë ky kuvend, ndryshimi bëhet nga organi që ka miratuar. Me qenë me PZHK, çështja nuk na adresohet fare neve këtu.

**znj. Ardita Rrahmani:** Me qenë me PZHK, çështja nuk vjen fare këtu.

**z. Agim Mani:** Komisioni duhet me dalë në vendngjarje dhe me shikuar se a i plotëson kriteret ajo pronë me iu ndërruar destinimi.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka. Këtë pikë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF

#### **Aprovoj**

**Propozim Vendimin për ndërrimin e destinimit të tokës pyjore në ndërtimore, në parcelën kadastrale Nr.P-70917083-00112-3, ZK Kaçanik i Vjetër. Propozim Vendimi i**

#### **Rekomandohet**

**Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.**

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, kështu e konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora: 12:05. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 6 anëtarët që ishin edhe në fillim.

Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 28.12.2023 në ora 11:00.

Procesmbajtëse  
Makfire Malsiu

*Malsiu*

